

### Fëmija im me bronkiolitis (Moj otrok ima bronhiolitis)

**Ç'është bronkiolitisi?** Bronkiolitisi është infekzion i organeve fryshtësore të poshtme, i cili godet rrugët e vockla fryshtësore degëzuese të quajtura bronkiale. Përmes bronkialeve ajri përcillet në mushkëri dhe nga mushkëritë. Gjatë infekzionit rrugët fryshtësore janë të enjtura dhe përplot me jargë. Për këtë arsyе fëmija fryshtëse me vështirësi.

Zakonisht bronkiolitisi godet fëmijët e moshës deri 2 vjeçare. Tek shumica e fëmijëve bronkiolitisi shërohet vetveti, tek disa fëmijë është e duhur kontrolli i pediatrit, kurse tek disa fëmijë të tjerë është e duhur dhënia e oksigjenit shtesë në ajrin fryshtësor andaj edhe duhet të shtrihen në spital. Si raste më të eksponenti rëndë janë para së gjithash fëmijët e moshës nën 6 muajsh.

Bronkiolitisin e shkaktojnë viruset. Njëri nga viruset më të shpeshta ndër to është virusi respirator sincicial (VRS). Zakonisht viruset barten nga fëmijët si motë a vëlla më të vjetër apo anëtarët tjerë familjarë tek të cilët janë të shprehura vetëm se shenjat e ftohjes. Numri më i madh i të infektuarve me këtë virus ndodh gjatë muajve të vjeshtës dhe dimrit, edhe pse ky infekzion mund të paraqitet në çdo stinë të vitit.

**Cilat janë simptomat e bronkiolitisit?** Zakonisht infekzioni fillon me paraqitjen e shenjave të para inflamatore. Fëmija ka:

- hundët e myllura apo rrjedhje nga hunda,
- kollitje,
- temperaturë të trupit të rritur (temperatura më e lartë se 38 °C) dhe
- apetit të zvogëluar.

Pasi që të përparoj bronkiolitisi mund të paraqiten edhe:

- fymëmarrja e shpejtë ose e vështirësuar, që manifestohet me frekuencë të rritur fymëmarrjeje në gjumë, thellim të hapësirave midis brinjëve, gjëma,
- tek foshnjat mund të paraqiten pushimet midis fymëmarrjeve, e që zgjasin më tepër se 15 apo 20 sekonda,
- fërshëllima dhe pëlcitje mbi mushkëri, e që i ndien mjeku me stetoskop,
- për shkak të fymëmarrjes së vështirësuar fëmija nuk pinë dhe nuk han,
- gjatë thithjes apo ushqimit me shishe foshnja mund të lodhet së tepërmë.

**ME SHENJAT E SIPËRPËRMENDURA TEK ZHVILLIMI I SËMUNDJES JU DUHET QË BASHKË ME FËMIJËN URGJENTISHT TA VIZITONI MJEKUN TUAJ APO PEDIATRIN KUJDESTAR!**

**Si shërohet bronkiolitis?** Shërimi i bronkiolitisit është simptomatik. Procedurat më të rëndësishme janë ato përmes të cilave fëmija juaj merr sasira të mjaftueshme të oksigjenit. Për ta arritur këtë, në rastet kur kjo është e duhur, në ajrin fymëmarrës duhet shtuar sasinë e oksigjenit, por mund të përdoren edhe medikamente për hapjen e rrugeve fymëmarrëse – bronhodilatatorët.

Zakonisht fëmijën nuk e shërojmë me antibiotikë, pasi që bronkiolitisin e shkaktojnë viruset dhe antibiotikët nuk ndikojnë në viruse.

**A mund të bëjmë gjë, në mënyrë që fëmija të ndjehet më mirë? Po. Mundemi.**

- kujdesuni, që fëmija juaj të merr sasira të mjaftueshme lëngjesh,
- zvogëlojeni temperaturën e rritur të fëmijës nëse ajo është më e lartë se 38,5 °C, (kurrë mos i jepni Aspirinë fëmijës më të vogël se 18 vjeç!),
- kujdesuni për një depërtueshmëri të mirë të hundës së fëmijës përmes një tualeti të rregullt me tretje fiziologjike disa herë në ditë,
- bashkë me fëmijën shmanguni infektimeve të mundshme të reja të organeve fymëmarrëse – mos shkoni me fëmijë të vogël nëpër qendra tregtare, mos qëndroni në lokale e vende ku ka shumë njerëz,
- bashkë me fëmijën shmanguni tymit të duhanit.

**Si e mori fëmija im bronkiolitisin?** Brokhiolitisin e shkaktojnë viruset, të cilët përhapen nga një person në tjetrin. Këto virusë jetojnë në pikat, të cilat shkojnë në ajër, kur i sëmuri kollitet apo teshtitë.

**A është i mundur parandalimi i bronkiolitisit?** Mundësia që fëmija i juaj të infektohet me bronkiolitis mund të zvogëlohet përmes këtyre masave:

- kujdesuni për një higjenë të mirë të duarve dhe kollitjes – duart tuaja dhe të fëmijës i lani shpeshherë me sapun dhe ujë, mund të përdorni edhe dezinfektues për duar,
- shmanguni lokale e vende ku ka shumë njerëz,
- personat e ftohur i lutni që t'mos e vizitojnë fëmijën tuaj përderisa të mos shërohen plotësisht,
- shmanguni tymit të duhanit,
- NËSE ËSHTË E MUNDUR MOS LEJONI QË GJATË KOHËS SË INFEKTIMEVE TË SHPESHTA TË ORGANeve FRYMËMARRËSE FËMIJËT SI MOTËR A VËLLA MË TË VJETËR T'MOS E VIZITOJNË KOPSHTIN.**

## SAMO NA ARHIVSKEM IZVODU

Pripravil/i:	Ana Kotnik Pirš, dr.med., Abedin Maliqi (prevajalec)		
Pregledal:	Uroš Krivec, dr.med.	Datum: 12.1.2016	podpis
Skrbnik procesa:	Uroš Krivec, dr.med.	Datum: 12.1.2016	podpis
Odobril:	Uroš Krivec, dr.med.	Datum: 12.1.2016	podpis

## PREGLED PREDHODNIH IZDAJ

Izdaja	Opis sprememb/e dokumenta	Datum
1	Inicialna izdaja	12.1.2016